



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

NJOFTIM

Nr. 707/3

Shkodër 01.03.2022

Njoftohen të gjithë të interesuarit se në Universitetin e Shkodrës "Luigj Gurakuqi", shpallet konkursi për 1 vend të lirë pune në Fakultetin e Drejtësisë, në pozicionin Asistent/Lektor/e në Departamentin e së Drejtës Ndërkombëtare Europiane.

Kandidati/ja duhet të plotësojë këto kritere specifike:

1. Të ketë kryer studimet universitare dhe pasuniversitare me kohë të plotë në Drejtësi.
2. Të ketë kryer ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në Drejtësi me notë mesatare jo më pak se 9.5.
3. Për kandidatët që kanë kryer studimet në sistemin 4 vjeçar mesatarja e tyre të jetë jo më 9.5
4. Për të diplomuarit jashtë vendit kërkohet çertifikata e njohjes nga MAS.
5. Të kenë të mbrojtur një gjuhë të huaj perendimore (preferohet anglisht) me notë mesatare jo më të ulët se 9.

Kandidatët duhet të plotësojnë këto kritere të përgjithshme :

1. Të kenë aftësi të punës në grup dhe aftësi komunikimi profesional.
2. Mos të jenë të dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykata.
3. Të mos jetë marrë ndaj tyre masë disiplinore sipas parashikimit në kodin e punës.
4. Të mos jetë larguar nga USH pa miratimin e këtij të fundit.
5. Të mos ketë lidhje familjare (bashkëshort/bashkëjetues, bir/bijë dhe fëmijët e tyre), gjinie(prindër, motër e vëlla dhe fëmijët e tyre emtë a ungj) apo krushqie(prind, fëmijë, vëlla/motër i/e bashkëshortit/es si dhe bashkëshort/bashkëjetues i fëmijëve) me punonjës ekzistues brënda njësisë bazë të Fakultetit të Drejtësisë.
6. Të mos kenë prishur në mënyrë publike imazhin e USH-së.

Preferohen që kandidatët të kenë :

1. Eksperiencë mësimdhënieje në universitetet publike brënda ose jashtë vendit.

Kandidatët do ti nënshtrohen konkurimit me dosje, testimi me shkrim, intervistës dhe leksionit të hapur.

Kandidatët duhet të paraqesin këto dokumenta:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim.
2. Curriculum Vitae me foto personale.
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit.
4. Diplomë të Shkollës së Lartë ose fotokopje dhe lista e notave (të noterizuara).
5. Dy rekomandime nga mësimdhënës me grada/tituj shkencorë.
6. Fotokopje të artikujve të botuar, teksteve universitare apo parauniversitare, projekte shkencore, punime të tjera.
7. Dëshmi të njohjes së gjuhës së huaj të njohur zyrtarisht nga Ministria e Arsimit
8. Dëshmi për kualifikime të ndryshme, pjesmarrje në konferenca, seminare, trajnime, workshope etj.
9. Vërtetim nga prokuroria, gjykata si dhe dëshmi penaliteti.
10. Vërtetim i gjendjes shëndetësore (raport mjekësor për aftësinë në punë).
11. Vërtetim nga qendra e punës në të cilën ka punuar ose punon ose vërtetim papunësie nga zyra e punës.
12. Deklaratë që provon kushtet e pikës 3/c, të nenit 8 të Rregullores së posaçme të Universitetit për zënie dhe ruajtjen e vendit të punës(për moslidhje farefisnore).
13. Dokument identifikimi vetjak(fotokopje pasaporte, letërnjoftimi ID).
14. Listë përmbledhëse e dokumenteve të dorëzuara nga konkurenti.
15. Çdo dokument tjetër që vërteton kërkesat e mësipërme.

Të gjithë dokumentet e mësipërme duhet të jenë origjanel ose të fotokopjuara dhe të noterizuara sipas legjislacionit në fuqi.

Shënim :

- Kontrata e punës do të jetë me afat 1 vjeçar (vit akademik) me të drejtë rinovimi.
- Kandidatët duhet të dorëzojnë postë pranë zyrës së protokollit në Rektoratin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, me shënimin mbi zarf “Aplikim për pedagog në FD”.
- Konkursi do të zhvillohet me dosje, intervistë dhe leksion të hapur brënda 3 javëve nga publikimi i njoftimit sipas orarit që do të përcaktojë Departamenti.
- Për hollësi të mëtejshme, si programi, mënyra e zhvillimit të konkursit , t’i drejtoheni Departamentit përkatës.


REKTORË
Prof. Dr. Suzana GOLEMI